



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.02.2023

Nr: 55

Ora: 15.00

VENDIM

PËR

**LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARIT TË KZAZ NR.43, BASHKIA RROGOZHINË, DHE ANËTARIT TË**

**KZAZ NR. 57, BASHKIA FIER**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenin 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V Ë R E N:**

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia e Lirisë, me shkresën nr. 460/3 Prot. dhe shkresën nr. 460/4 Prot., datë 13.02.2023, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.43 bashkia Rrogozhinë, dhe KZAZ-së nr.57, bashkia Fier.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## **V E N D O S:**

1. Lirimin nga detyra të z. Adriatik Zydi Kasa, anëtar i KZAZ-së nr. 43, bashkia Rrogozhinë.
2. Emërimin e z. Indrit Hamid Dedej, anëtar i KZAZ-së nr. 43, bashkia Rrogozhinë.
3. Lirimin nga detyra të z. Fatos Sheshi anëtar i KZAZ-së nr. 57, bashkia Fier.
4. Emërimin e z. Shkëlzen Pëllumb Osmëni, anëtar i KZAZ-së nr. 57, bashkia Fier.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**